

MENAXHIMI I MBETURINAVE FARMACEUTIKE



Mbeturinat farmaceutike duhet të magazinohen në vende të ndara dhe të dedikuara për produktet farmaceutike të cilat më nuk do të përdoren.

Mbeturinat e produkteve farmaceutike duhet të ruhen në thasë prej najloni me ngjyrë të gjelbër dhe etiketohen, ku duhet të shënohen informacionet themelore për prodhuesin, numrin e mbeturinës dhe emrin e saj në përputhje me ligjin.

Personi i licënsuar për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave (mbeturinat farmaceutike transportohen me mjete të veqanta), mbledh mbeturinën prej prodhuesit dhe/apo zotëruesit dhe atë e transporton deri tek objekti në të cilin bëhet administrimi i mbeturinave.

Për asgjësimin e mbeturinave farmaceutike, personat juridik dhe fizikë duhet të bëjnë kërkesë në MMPH të cilës i bashkangjiten këto dokumente:

- Listën e klasifikuar të mbeturinave,
- sasinë,
- kategorizimin sipas rrezikshmërisë,
- shënimet sipas grupit terapeutik dhe
- përshkrimin e shkurtër të mënyrës së asgjësimit.

PËRPARËSITË NGA ADMINISTRIMI I MIRË I MBETURINAVE MEDICINALE

Mbeturinat farmaceutike që janë gjeneruar në sasi të mëdha mund të asgjësohen me metoda të ndryshme dhe të shndërrohen në materiale të dobishme, p.sh. për ngrohjen e qytetit (metodë që e kanë aplikuar disa shtete).



The ENV.Net project is financed by the EU Commission, managed by the Punto Sud and implemented in Kosovo by ATRC.



BARNAT E PAPËRDORSHME NUK GUXOJNË TË HUDHEN NË MBETURINAT E ZAKONSHME!





BARNAT E PAPËRDORSHME HYJNË NË GRUPIN E MBETURINAVE TË RREZIKSHME!

MBETURINAT FARMACEUTIKE

Mbeturinat medicinale-farmaceutike klasifikohen në grupin e mbeturinave të dëmshme apo të rrezikshme. Si rezultat i materjeve të ndryshme helmuese që përmbajnë mbeturinat medicinale përbëjnë një rrezik jo vetëm për shëndetin e njeriut por edhe për ambientin në tërësi.



VINI RE:
Barnat me afat të skaduar ose të papërdorshme NUK GUXOJNË TË HUDHEN NË MBETURINAT E ZAKONSHME!



TË DREJTAT E QYTETARIT

Udhëzimi Administrativ 05/2008 për Administrimin e Mbeturinave, përkatësisht Ligji për Pajisje dhe Produkte Medicinale përcakton:

Qendrat e Mjekësisë Familjare janë të obliguara që nga qytetarët të pranojnë medikamente me afat të skaduar të përdorimit, ose të dëmtuara duke i vërtetuar ato nga mjeku me recetë apo raport.



Barnatorja është e detyruar të pranojë produktet medicinale të papërdorshme të dorëzuara nga persona fizik.

LEGJISLACIONI

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave medicinale-farmaceutike në Kosovë është i rregulluar me Ligjin për Mbeturina 02/L -30, Udhëzimin Administrativ 05/2008 për Administrimin e Mbeturinave dhe Udhëzimin Administrativ 12/2008 për Asgjësimin e Mbeturinave të Produkteve Medicinale.

Sipas këtyre udhëzimeve në fuqi:

Mbeturinat e produkteve medicinale të cilat nuk duhet të përdoren dhe duhet konsideruar gjithmonë si mbeturina të dëmshme dhe të rrezikshme, janë:

- a) barnat që u ka skaduar afati i përdorimit;
- b) të gjitha shurupet, suspensionet apo pikat për sy (të hapura, me afat të skaduar apo jo);
- c) të gjitha mbeturinat nga barnat e zingjirit të ftohtë (që ruhen në temperatura të ulëta), të pa skaduar, por që nuk janë ruajtur në temperaturë të ultë ashtu siq kërkohet (p.sh. insulina, hormonet polypeptide, gamaglobulinat dhe vaksinat);
- d) të gjitha kaspulat, tabletat e hapura, të përziera dhe të pa paketuara;
- e) tubat e kremrave jo të mbyllura (që u ka skaduar ose jo, afati i përdorimit)
- f) tubat e yndyrave, pastave të pambyllura dhe të dyshimta (që u ka skaduar ose jo, afati i përdorimit)